



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 56

Tiranë – E martë, 12 prill 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 26/2022, datë 17.3.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave.....
	7807
Dekret i Presidentit nr. 13533, datë 7.4.2022	Për shpallje ligji.....
	7811
Ligj nr. 27/2022, datë 17.3.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare.....
	7811
Dekret i Presidentit nr. 13534, datë 7.4.2022	Për shpallje ligji.....
	7817
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1, datë 22.2.2022	Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit
	7817
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12, datë 8.4.2022	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1917, datë 1.9.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”
	7819
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 124, datë 4.4.2022	Për miratimin e “Programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues për ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë”
	7819
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 133, datë 7.4.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar.....
	7825



LIGJ
Nr. 26/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
ZBATIMIN E LEHTËSIRAVE
TË NDËRSJELLA NË PROCEDURAT
DOGANORE DHE/OSE TË
KONTROLLIT TË HYRJE-DALJES
SË MALLRAVE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.3.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13533, datë 7.4.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
PËR ZBATIMIN E LEHTËSIRAVE TË
NDËRSJELLA NË PROCEDURAT
DOGANORE DHE/OSE TË KONTROLLIT
TË HYRJE-DALJES SË MALLRAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të referuara si “Palët” në këtë marrëveshje),

nisur nga vullneti i mirë për të forcuar dhe për të zhvilluar më tej bashkëpunimin;

me synimin arritjen e objektivave për shfrytëzimin efektiv të infrastrukturës së dy vendeve;

me qëllim zbatimin e lehtësirave dhe të thjeshtimeve në procedurat doganore dhe/ose masave në lidhje me kontrollin në qarkullimin e mallrave ndërmjet dy vendeve, duke eliminuar procedura burokratike në kufi dhe terminale doganore;

si konfirmim i “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë”, datë 11 janar 2014,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është zbatimi i lehtësirave, thjeshtimi i kryerjes së procedurave doganore dhe zvogëlimi i kohës së pritjes në pikat e kalimit kufitar, me anë të:

a) kryerjes së procedurave doganore dhe/ose të kontrolleve të vendit tjetër, për mallrat që kanë destinacion hedhje në qarkullim të lirë/destinacion final të përdorimit në territorin doganor të këtij vendi, nga personeli doganor i këtij vendi, që do të vendoset pranë zonave doganore (zona) të vendit pritës;

b) kryerjes së procedurave doganore dhe/ose kontrolleve të vendit tjetër (RSH apo RK) ndjekur nga procedura doganore e eksportit të vendit eksportues dhe njohjes reciproke të certifikatave të sigurisë në eksport, për mallrat fruta dhe perime (zarzavate), (kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Mallrave) të prodhuara në RSH apo RK, që do të



hidhen në qarkullim të lirë/destinacion final të përdorimit në territorin doganor të RSH-së apo RK-së, pas eksportit direkt nga RSH-ja apo RK-ja;

c) njohjes reciproke nga palët, të licencave të agjencive doganore dhe të regjistrimit të tyre pranë autoriteteve kompetente doganore të palëve, për kryerjen e deklarimit, në përputhje me gërmat “a” dhe “b” dhe të veprimeve të tranzitit në territorin doganor të RSH-së apo RK-së, përfshirë njohjen dhe vendosjen e garancisë për borxhin e mundshëm në këtë regjim;

ç) miratimit të rregullave për vendosjen, kryerjen e procedurave dhe lëvizjen në territorin e palëve të personelit zyrtar të tyre;

d) përcaktimit që, në Zonën Doganore të Portit të Durrësit dhe Porto-Romanos, vendoset zyra doganore e Republikës së Kosovës (RK) dhe në vijim, sipas interesit reciprok të palëve, vendosjen e zyrave dhe të agjencive të tjera të palës tjetër, në zonat doganore në territorin doganor të palës vendëse;

2. Përmes nënshkrimit në emër të Palëve të protokolleve të veçanta, Palët miratojnë edhe vendosjen e zyrave të tjera dhe/ose zgjerimin e mëtejshëm të lehtësimit dhe të thjeshtimit të procedurave doganore dhe/ose kontrollit të hyrje-daljes së mallrave.

Neni 2

Përkufizime

a) “Zonë” është zona doganore, pjesë e territorit të palës (shtetit) vendës, në të cilën personeli zyrtar i shtetit tjetër është i autorizuar për të kryer procedurat doganore dhe/ose kontrolle.

b) “Palë vendëse” është pala, në territorin doganor të së cilës është zona, ku do të kryhen veprimet apo procedurat e kontrollit nga ana e personelit zyrtar të palës tjetër.

c) “Palë tjetër” është pala, personeli zyrtar i së cilës, kryen veprimet apo procedurat e kontrollit brenda zonës së vendosur në territorin doganor të palës vendëse.

ç) “Personeli zyrtar” nënkupton personat e autoriteteve kompetente shtetërore të palëve, që kryejnë kontrollin e detyrueshëm kufitar të mallrave, në territorin e palëve;

d) “Protokolle” nënkupton akte zbatuese që do të lidhen midis autoriteteve zbatuese, që përcaktojnë aspekte të lidhura me funksionimin dhe me zbatimin e marrëveshjes;

dh) “Karta e identitetit” nënkupton kartën zyrtare të shërbimit, që i jep personelit zyrtar të drejtën të hyjë në Zonën Doganore, të punojë në të dhe të kthehet në vendin tjetër.

Neni 3

Procedurat dhe kontrollet

1. Në zonën e palës vendëse, ligjet dhe rregulloret e palës tjetër, janë të vlefshme, në lidhje me kalimin e kufirit të mallrave (importin, eksportin dhe transitin), sipas parimeve të mëposhtme:

a) mallrat do të trajtohen me të njëjtat procedura dhe do të kenë të njëjtat pasoja ligjore, sikur të ishin në territorin e palës tjetër;

b) veprimet e tilla, si ato doganore, policore apo ndërhyrje të tjera, si dhe ndalimi i personave dhe bllokimi i mallrave, duhet të jenë në përputhje me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse të palëve;

c) në një kohë që për mallrat përfundon procedura apo kontrolli i punonjësve apo i agjencive të palës tjetër, fillojnë kompetencat e autoriteteve të palës vendëse, për të vijuar procedurat dhe kontrollet e nevojshme;

ç) institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit të Palëve, ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me autoritetet doganore të palëve, sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre;

d) kur për të njëjtat mallra, përveç kontrolleve doganore, kryhen kontrolle edhe nga autoritete të tjera kompetente, autoritetet doganore të palëve, në bashkëpunim të ngushtë me këto të fundit, kur është e mundur, i kryejnë këto kontrolle në të njëjtin vend e kohë me kontrollin doganor (*one-stop-shop*). Autoritetet doganore të palës vendëse kanë rolin koordinues në këto kontrolle;

dh) kontrollet doganore, përveç kontrolleve të rastësishme, do të mbështeten kryesisht në analizën e riskut, duke përdorur teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, me qëllim identifikimin e vlerësimit të riskut dhe zhvillimin e masave kundërvepruese të nevojshme, në bazë të kriterëve të hartuara në nivel kombëtar dhe brenda një kornize të përbashkët të menaxhimit të riskut, duke u bazuar në shkëmbimin e informacionit për risqet dhe rezultatet e analizave të riskut ndërmjet administratave doganore të palëve, duke vendosur



kritere dhe standarde risku të përbashkëta, duke marrë masa kontrolli, e duke përcaktuar fusha prioritare kontrolli.

2. Personeli zyrtar i autoriteteve të palës tjetër, duke kryer funksionet e tyre në lidhje me mallrat në palën vendëse, do të jetë përgjegjës vetëm ndaj autoriteteve të shtetit të tyre.

3. Personeli zyrtar i autoriteteve të palës tjetër do të ketë të drejtë të kryejë funksione në zonën e palës vendëse. Personeli është i detyruar të informojë autoritetet kompetente të palës vendëse, mbi veprimet dhe masat e ndërmarra, përfshirë rastet kur kontrollet fizike të mallrave, për arsye objektive, do të kryhen në territorin doganor të palës tjetër. Pala vendëse është e detyruar të njoftojë menjëherë, personelin e autoritetit të palës tjetër për vendimin e tij.

4. Personeli i palëve është i detyruar të bashkëpunojë me njëri-tjetrin.

5. Personeli zyrtar i palës tjetër ka të drejtën e dërgimit falas të sendeve vetjake, të cilat janë ndaluar përkohësisht në zonë, si dhe burimet financiare të mbledhura në zonë, përmes kufirit shtetëror në territorin e shtetit të tij.

6. Mallrat tregtare të kapura dhe të konfiskuara gjatë kontrolleve kryera nga personeli zyrtar i palës tjetër, nuk do të jenë objekt i kontrollit nga ana e personelit të palës vendëse.

7. Mallrat e ndaluara, të kapura dhe të konfiskuara gjatë kontrolleve të kryera, nga personeli zyrtar i palës tjetër, do t'i dorëzohen personelit të palës vendëse.

8. Protokollet ndërmjet autoriteteve kompetente shtetërore të palëve do të përcaktojnë më hollësisht realizimin e procedurave dhe të kontrollit të përcaktuar në këtë nen dhe në pikën I, të nenit 1.

9. Aktet e miratuara deri më tani nga palët, që kanë të bëjnë me lehtësimin e procedurave doganore dhe kontrollet, mbeten në fuqi, për aq sa ato nuk bien ndesh me këtë Marrëveshje.

Neni 4

Kontrolli i mallrave në tranzit

1. Kontrolli i mallrave në tranzit kryhet nga autoritetet kompetente të palës vendëse.

2. Në rastet kur gjatë procedurës së zhdoganimit autoritetet e vendit tjetër lëshojnë certifikatë fitosanitare, veterinare apo ndonjë licencë/leje tjetër, e njëjta do të konsiderohet e pranueshme/

valide për palën vendëse në zbatim të procedurës së tranzitit.

3. Çdo mall i kapur (sekuestruar/konfiskuar) nga autoritetet kompetente të palës vendëse gjatë kontrollit në tranzit, do të jetë objekt i ligjeve të autoritetit të palës vendëse.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit dhe sistemet informatike

1. Gjatë kohës në detyrë, personeli zyrtar mund të shkëmbejë vetëm informacion të paklasifikuar si sekret, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

2. Sistemet informatike të palëve me shpenzimet respektive të tyre, duhet të sigurojnë përputhshmërinë dhe ecurinë normale të deklarimeve, të përcaktuara në këtë marrëveshjeje.

3. Shkëmbimi i informacionit, ndërveprimi dhe përputhshmëria e sistemeve do të kryhet mbi bazën e Protokollit të veçantë, të lidhur ndërmjet autoriteteve kompetente doganore të palëve kontraktuese.

Neni 6

Statusi i personelit zyrtar të palës tjetër

1. Gjatë kohës në detyrë, personeli zyrtar i autoriteteve të palës tjetër ka të drejtën e hyrjes së lirë në zonën e palës vendëse, me uniformën e palës tjetër dhe pa armë. Personeli zyrtar i palës tjetër, gjatë detyrës brenda në zonë, duhet të ketë të veshur uniformën zyrtare dhe/ose simbole të dukshme zyrtare.

2. Personeli i palës tjetër merr të njëjtën mbrojtje dhe mbështetje si personeli i palës vendëse.

3. Për personelin e palës tjetër, ligjet dhe rregullat e shtetit të palës tjetër, janë të vlefshme në zonë.

4. Nëse dikush nga personeli i palës tjetër vritet ose plagoset, i humbin gjërat personale që i mban me vete (uniformat etj.) gjatë detyrës, zbatohen ligjet dhe rregullat e shtetit të palës vendëse.

5. Veprat apo shkeljet penale të kryera brenda zonës, të drejtuara kundër personelit zyrtar të palës tjetër që janë në detyrë, do të trajtohen në përputhje me legjislacionin e shtetit të palës vendëse, sipas të njëjta kushteve sikur t'i kishin ndodhur personelit zyrtar të palës vendëse.



Procedurat përcaktohen me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse kompetente.

6. Veprat apo shkeljet penale të kryera kundër detyrës zyrtare, nga personeli zyrtar i palës tjetër që janë në detyrë, do të trajtohen në përputhje me legjislacionin e shtetit të autoriteteve të palës tjetër.

7. Çështje të tjera, që lidhen ne personelin zyrtar, do të rregullohen me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse kompetente.

Neni 7

Zyrat, hapësirat, sendet, automjetet dhe shërbimet

1. Në zonë, personelit zyrtar të palës tjetër i sigurohet zyra dhe hapësira e nevojshme për ushtrimin e detyrave të tyre funksionale.

2. Në lidhje me përdorimin e hapësirës dhe të zyrave në zonë, që u caktohen autoriteteve të palës tjetër, kjo e fundit do të lidhë kontratat përkatëse, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

3. Godinat, zyrat, hapësira dhe automjetet duhet të identifikohen me mbishkrimin dhe me simbolin apo stemat kombëtare.

4. Sendet e përdorura gjatë ushtrimit të detyrës nga personeli zyrtar i palës tjetër në/ose jashtë territorit të shtetit të palës vendëse, nuk janë objekt i detyrimeve doganore dhe/ose i detyrimeve të tjera të pagueshme në import.

5. Autoritetet kompetente mund të lidhin protokollat përkatëse mbi çështjet e përmendura në këtë nen.

Neni 8

Karta e identitetit për personelin zyrtar

1. Personeli zyrtar i palës tjetër duhet të pajiset me karta të veçanta identifikimi për të vepruar brenda zonës.

2. Kartat zyrtare të identitetit lëshohen nga autoritetet kompetente të palëve për një periudhë njëvjeçare. Afati i vlefshmërisë duhet të zyrtarizohet nga ana e organeve kompetente të të dyja palëve kontraktuese.

3. Autoriteti lëshues është i detyruar të shfuqizojë menjëherë kartën e identitetit në përfundim të arsyeve për të cilat ajo është lëshuar dhe është i detyruar të njoftojë menjëherë me shkrim autoritetet kompetente të palës tjetër. Në këtë rast, autoritetet që lëshojnë dokumentet duhet

të informojnë menjëherë me shkrim autoritetet përkatëse të shtetit të palës tjetër.

Neni 9

Pajisjet e telekomunikacionit

1. Pala vendëse duhet të japë leje, pa pagesë, për instalimin e pajisjeve të telekomunikacionit që janë të domosdoshme për punën e autoriteteve të palës tjetër në zonën e palës vendëse, si dhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet e duhura të shtetit të palës vendëse.

2. Shpenzimet për instalimin, mirëmbajtjen dhe operimin e mjeteve të telekomunikacionit janë në ngarkim të palëve respektive.

Neni 10

Gjuha

1. Në zonë, gjatë komunikimit të personelit zyrtar, do të përdoret gjuha shqipe.

2. Komunikimet me shkrim do të zhvillohen në gjuhët që janë në përdorimin zyrtar në të dyja shtetet.

Neni 11

Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve

1. Palët do të krijojnë një komitet të përbashkët të ekspertëve (në vijimin “KPE”), i cili do të hartojë manuale të posaçme mbi çështjet teknike dhe financiare, që lidhen me funksionimin e kontroleve, të protokolleve, si dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes.

2. KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përhershëm nga secila palë që përfaqësojnë autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

3. Sipas kërkesës dhe çështjeve që trajtohen, në KPE marrin pjesë dhe agjenci apo institucione të tjera të përfshira.

4. Mosmarrëveshjet e mundshme rreth shpjegimit apo zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen nga KPE-ja.

5. Në rast se brenda afatit prej 3 muajsh, KPE-ja nuk do të mund të gjejë zgjidhje të pranuar nga të dyja palët në këtë marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve të ndërsjella në rrugë diplomatike ndërmjet dy qeverive deri në fundin e muajit pasardhës.



Neni 12

Klauzola e pezullimit

Për arsye sigurie kombëtare apo për mbrojtjen e interesit publik, secila prej Palëve mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e marrëveshjes apo të secilës prej dispozitave të saj, në kushte të rrethanave që diktojnë një vendim të tillë në territorin e tyre. Pala tjetër kontraktuese njoftohet menjëherë me shkrim.

Neni 13

Vlefshmëria

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar, me mundësinë e përfundimit të saj me nismën e secilës nga Palët.

2. Vlefshmëria e marrëveshjes do të përfundojë gjashtë muaj pas ditës së marrjes së notës diplomatike, përmes së cilës pala tjetër njofton përfundimin e marrëveshjes.

3. Me përfundimin e kësaj marrëveshjeje, shfuqizohen të gjitha protokollat e miratuara në zbatim të saj.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilave Shtetet Palë konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Z.Edi Rama

KRYEMINISTËR

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Z.Albin Kurti

KRYEMINISTËR

DEKRET**Nr. 13533, datë 7.4.2022****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 26/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta**LIGJ****Nr. 27/2022**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE
NË ÇËSHTJET CIVILE
DHE TREGTARE**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1; 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.3.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13534, datë 7.4.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE
NË ÇËSHTJET CIVILE DHE TREGTARE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “Palët”;

duke njohur aspiratën e tyre për të zgjeruar bashkëpunimin juridik edhe në çështjet civile dhe tregtare;

duke marrë në konsideratë qëllimin e realizimit më efikas të të drejtave dhe interesave të ligjshëm të të dy shteteve dhe shtetasve të tyre;

duke synuar forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve,

kanë rënë dakord me sa vijon:

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

1. Palët, në bazë të kërkesës, i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë juridike, në shkallën më të gjerë nën kushtet dhe mënyrat e përcaktuara me këtë marrëveshje.

2. Kjo marrëveshje zbatohet për çështjet civile dhe tregtare, që përfshijnë procedurat lidhur me gjendjen civile, çështjet familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet e pronësisë, trashëgiminë dhe marrëdhëniet e tjera civile ose tregtare të personave fizikë dhe juridikë, përveç rasteve të përjashtuara shprehimisht me këtë marrëveshje.

3. Ndhimën juridike e ofrojnë organet gjyqësore dhe organet e tjera të palëve, të cilat sipas legjislacionit në fuqi në shtetin e tyre janë kompetente të vendosin për çështjet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 2

Parimet

1. Shtetasit e njëres palë në territorin e palës tjetër gëzojnë mbrojtje të njëjtë juridike të të drejtave për të cilat zbatohet kjo marrëveshje me shtetasit e palës tjetër.

2. Shtetasit e njëres palë në territorin e palës tjetër kanë qasje të lirë pranë gjykatave dhe organeve të tjera. Ata mund t'i mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshëm, të parashtrojnë kërkesa dhe të ndërmarrin veprime para këtyre organeve në kushte të njëjta me shtetasit e palës tjetër.

3. Shtetasit e njëres palë në territorin e palës tjetër kanë të drejtën e ndihmës juridike falas dhe të përjashtimit nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore në procedurat për të cilat zbatohet kjo marrëveshje sikurse shtetasit e palës tjetër.

4. Dispozitat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen njëloj edhe te personat juridikë të themeluar në përputhje me legjislacionin e palës në territorin e së cilës ndodhet selia e tyre.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

1. Në bazë të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi sigurohet në format e mëposhtme:

i. ndihmës së ndërsjellë juridike, si: dorëzimi i letërthirrjeve dhe dokumenteve të tjera gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, marrja e dëshmisë nga palët dhe dëshmitarët, marrja e mendimeve të ekspertëve, ofrimi i informacioneve lidhur me dispozitat ligjore të brendshme;

ii. njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të arbitrazhit;

iii. çdo lloji tjetër të ndihmës që nuk është në kundërshtim me legjislacionin e palës së kërkuar.

2. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike përfshijnë letërkërkesat sipas legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe lutjet, dhe letërporosi sipas legjislacionit të brendshëm të



Republikës së Kosovës, brenda fushës së bashkëpunimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Gjuha dhe kanalet e komunikimit

1. Kërkesat për ndihmë juridike dërgohen nga organet gjyqësore përmes autoriteteve qendrore të palëve.

2. Autoriteti qendror për Republikën e Shqipërisë është Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti qendror për Republikën e Kosovës është Ministria e Drejtësisë.

3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk e përjashton mundësinë e komunikimit përmes kanaleve diplomatike nëse ka arsye, si dhe komunikimin e drejtpërdrejtë në mes të organeve gjyqësore.

4. Komunikimi elektronik lejohet me kusht që pala kërkuuese garanton dërgimin e kërkesës në original.

5. Kërkesa për ndihmë juridike dhe dokumentet shoqëruese dorëzohen në gjuhën e palës kërkuuese.

6. Përgjigjet në kërkesat për ndihmë juridike dorëzohen në gjuhën e palës së kërkuar.

KAPITULLI II

NDIHMË E NDËRSJELLË JURIDIKE

Neni 5

Përmbajta e kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike

1. Kërkesa për ndihmë juridike, dorëzohet me shkrim dhe për aq sa është e mundur përmban:

i. emërtimin e organit të palës kërkuuese;

ii. emërtimin e organit tek i cili dërgohet kërkesa, nëse është i njohur;

iii. të dhënat e palës si: emrin dhe mbiemrin, adresën ose vendqëndrimin e përhershëm/përkohshëm, profesionin, shtetësinë dhe cilësinë e tij në procedurë;

iv. në rast se pala është person juridik emrin e kompanisë dhe adresën e selisë;

v. nëse palët kanë përfaqësues emrin, mbiemrin dhe adresën e tyre;

vi. numrin e regjistrimit dhe përshkrimin e çështjes për të cilën kërkohet ndihma juridike;

vii. objektin e letërporosisë, natyra e dokumentit i cili do të dorëzohet; provat të cilat duhet të merren apo veprime të tjera gjyqësore të cilat duhet

të ndërmerren dhe sipas rastit pyetjet që duhet t'i parashtrihen personit që kërkohet të merret në pyetje.

2. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese duhet të dërgohen në original apo kopje të njësuara me origjinalin.

3. Pala e kërkuar mund të kërkojë shpjegime dhe dokumente shtesë që janë të nevojshme për përmbushjen e kërkesës.

Neni 6

Refuzimi i ndihmës juridike

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë ndihmën juridike nëse konsiderohen që nuk plotësohen kushtet për dhënien e ndihmës juridike të parashikuara në këtë marrëveshje.

2. Pala e kërkuar mund ta refuzojë dhënien e ndihmës juridike edhe në rast se konsideron se plotësimi i saj cenon sovranitetin ose sigurinë e saj, ose vjen në kundërshtim me rendin e saj publik.

3. Pala e kërkuar njofton palën kërkuuese për arsyet e refuzimit të ndihmës juridike.

Neni 7

Veprimi lidhur me kërkesën

1. Nëse gjykata ose organi tjetër i treguar në kërkesë konstaton se nuk është kompetent për të vepruar, atëherë me nismën e tij ia përcjell atë gjykatës ose organit tjetër që është kompetent për të ekzekutuar atë që është brenda territorit të palës së kërkuar.

2. Pala e kërkuar njofton palën kërkuuese për përmbushjen ose mospërmbushjen e kërkesës. Në rast të mospërmbushjes, ajo tregon arsyet e mospërmbushjes dhe përcjell të gjitha dokumentet e dorëzuara tek autoriteti kërkuar.

Neni 8

Ekzekutimi i kërkesave

1. Kërkesat ekzekutohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të palës së kërkuar.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesat mund të ekzekutohen në mënyrën e kërkuar nga pala kërkuuese, nëse kjo nuk është në kundërshtim me ligjin e palës së kërkuar apo nëse kjo nuk paraqet vështirësi praktike. Nëse pala kërkuuese kërkon që dëshmitarët apo ekspertët të



dëshmojnë nën betim, betimi kryhet në përputhje me legjislacionin e palës së kërkuar.

3. Autoritet gjyqësorë ekzekutojnë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike pa vonesë dhe zbatojnë masa të njëjta detyruese, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, njëloj siç veprojnë për zbatimin e urdhrave të lëshuar nga autoritetet e vendit të tij ose kërkesat e bëra nga palët në procedurat e brendshme.

4. Autoriteti kërkuar, në bazë të kërkesës së parashtruar informohet në kohën e duhur mbi datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës në mënyrë që palëve të interesuara t'iu mundësohet pjesëmarrja.

5. Autoriteti qendror i palës së kërkuar mund të lejojë gjatë ekzekutimit të kërkesës pjesëmarrjen e personave të treguar nga pala kërkuese.

Neni 9

Letërporosia

1. Secila palë, sipas kushteve të parashikuara në këtë kapitull, mund t'i përcjellë autoriteteve kompetente gjyqësore të palës tjetër letërporosi, me qëllim sigurimin e provave, si: marrjen e dëshmive apo deklaratave nga dëshmitarët ose ekspertët, përcjelljen e dokumenteve ose të provave të tjera të siguruar. Letërporosia nuk përdoret për të siguruar prova, të cilat nuk do të përdoren në procedurë gjyqësore.

2. Kur kërkohet marrja në pyetje e një personi, ai mund të refuzojë të japë dëshminë, nëse ai përfiton nga e drejta për të mos dëshmuar apo nëse ai ka detyrimin për të mosdëshmuar:

- i. në bazë të ligjit të palës së kërkuar; apo
- ii. në bazë të ligjit të palës kërkuese, me kusht që ky privilegj apo detyrim të jetë përmendur në letërporosi apo në ndonjë mënyrë tjetër t'i jetë konfirmuar autoritetit të palës së kërkuar nga pala kërkuese.

3. Zyrtarët diplomatikë apo konsullorë të njëres palë, në territorin e palës tjetër, mund të marrin deklarata nga një person, të nevojshme në procedurën e filluar në gjykatën e shtetit, të cilin ata e përfaqësojnë, me kusht që personi në fjalë të ketë vetëm shtetësinë e shtetit dërgues të zyrtarit diplomatik apo konsullor. Deklarata sipas këtij paragrafi nuk mund të merret duke detyruar shtetasin e shtetit që ai përfaqëson. Marrja e

deklaratës mund të realizohet vetëm në hapësirat e përfaqësisë diplomatike apo konsullore.

Neni 10

Dorëzimi i dokumenteve dhe letërthirrjeve

1. Dorëzimi i dokumenteve dhe letërthirrjeve dëshmohet me vërtetim për dorëzim, i cili përpilohet sipas dispozitave të palës së kërkuar. Në vërtetim duhet të jenë të shënuar vendi dhe data e pranimit, si dhe emri, mbiemri dhe nënshkrimi i pranuesit. Nëse dokumenti nuk është dorëzuar, në vërtetimin për dorëzim duhet të paraqiten arsyet e mosdorëzimit të tij.

2. Nëse personi tek i cili duhet të kryhet dorëzimi nuk mund të gjendet në adresën e shënuar në kërkesë, pala e kërkuar, me kërkesën e palës kërkuese, ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për përcaktimin e adresës së saktë.

3. Kjo marrëveshje nuk ndërhyt në:

i. të drejtën e palëve për t'iu dorëzuar dokumentet shtetasve të tyre përmes zyrtarëve diplomatiko-konsullorë, pa i zbatuar masat detyruese;

ii. mundësinë që autoritetet gjyqësore të palës të dorëzojnë letërthirrje dhe dokumente të tjera gjyqësore te personat që ndodhen në territorin e palës tjetër, përmes autoriteteve gjyqësore të asaj pale.

Neni 11

Shpenzimet për dhënien e ndihmës juridike

1. Secila palë mbulon shpenzimet për dhënien e ndihmës juridike që janë bërë në territorin e saj, përveç rasteve kur kjo marrëveshje parashikon ndryshe.

2. Palët nuk kërkojnë kompensim të shpenzimeve për veprimet e kryera, për dhënien e ndihmës juridike, përveç shpenzimeve për pjesëmarrjen e ekspertëve dhe për përgatitjen e ekspertizës. Nëse shpenzimet e ekspertizës i mbulon një palë në procedurë, ekspertiza mund të kushtëzohet me parapagimin e shpenzimeve të gjykata e kërkuar.

3. Dëshmitari ose eksperti i paraqitur para organeve gjyqësore të palës kërkuese kompensohet nga kjo palë në përputhje me legjislacionin e saj. Në aktin e thirrjes së tij tregohet se cilat shpenzime i



kompensohen atij. Me kërkesë të tij këto shpenzime i parapaguhen.

Neni 12

Ndihma në gjetjen e personave

1. Palët i ofrojnë ndihmë njëra-tjetrës në përcaktimin e adresave të personave, të cilët gjenden në territorin e tyre, nëse kjo nevojitet për realizimin e të drejtave të tyre në procedurën para organeve të tyre kompetente dhe nëse për këtë qëllim jepen të dhëna përkatëse.

2. Kërkesa, sipas paragrafit 1 të këtij neni, dërgohet tek organi i palës tjetër në përputhje me nenin 4 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

Shkëmbimi i informacionit mbi legjislacionin

Palët me kërkesë shkëmbejnë tekstin e legjislacionit të tyre të brendshëm, si dhe çdo informacion për çështje të posaçme juridike, nëse kjo është e nevojshme në lidhje me procedurat që janë objekt i kësaj marrëveshjeje.

Neni 14

Përfshirja nga detyrimi për legalizim të dokumenteve

1. Dokumentet zyrtare të lëshuara nga gjykata, personat e autorizuar ose organe të tjera kompetente të njëres palë, brenda fushëveprimit të kësaj marrëveshjeje, të cilat janë të vërtetuara me nënshkrim dhe vulë zyrtare, nuk është e nevojshme të vërtetohen më tej për përdorim para organeve të palës tjetër.

2. Nuk është i nevojshëm legalizimi i dokumenteve private brenda fushëveprimit të kësaj marrëveshjeje, të cilat janë të vërtetuara paraprakisht nga gjykata, personi i autorizuar, ose organi tjetër kompetent i Palës.

3. Rregullat e këtij neni zbatohen edhe për kopjet e dokumenteve zyrtare dhe private brenda fushëveprimit të kësaj marrëveshjeje, të cilat i ka vërtetuar gjykata, personi i autorizuar, ose organ tjetër kompetent.

Neni 15

Fuqia provuese e dokumenteve zyrtare

Dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet kompetente të njëres palë kanë fuqi të njëjtë provuese para organeve të palës tjetër.

KAPITULLI III NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE DHE TË ARBITRAZHIT

Neni 16

Fusha e zbatimit

1. Kjo marrëveshje zbatohet për vendimet e lëshuara nga gjykatat e palëve në çështjet civile dhe tregtare.

2. Kjo marrëveshje nuk zbatohet në:

i. çështjet që lidhen me falimentimin ose likuidimin e shoqërive tregtare;

ii. çështjet për sigurimin social;

iii. vendimet për pagesë të detyrimeve doganore, taksave, si dhe dënimet për kundërvajtjet administrative që lidhen me to.

Neni 17

Kushtet ligjore

1. Vendimi gjyqësor i njëres palë të njihet dhe të ekzekutohet në palën tjetër nëse:

i. është shpallur nga gjykata e cila sipas legjislacionit të saj të brendshëm ka juridiksion dhe kompetencë për të vendosur; dhe

ii. në qoftë se nuk është më objekt i mjeteve të ankimimit dhe është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës.

Neni 18

Refuzimi

1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit gjyqësor refuzohet në rastet e mëposhtme:

i. nëse njohja dhe ekzekutimi i vendimit është në kundërshtim të hapur me rendin publik të palës së kërkuar; ose

ii. nëse vendimi është dhënë në mungesë të një prej palëve në procedurë, e cila nuk ka marrë njoftim për procedurën gjyqësore apo nuk ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Ky rregull nuk zbatohet nëse Pala nuk e ka ankimuar vendimin për këtë shkak edhe pse ka pasur mundësi për një gjë të tillë; ose

iii. nëse midis të njëjtave palë në procedurë, me të njëjtin objekt, kanë filluar procedura që:

a) janë në proces pranë një gjykate të palës së kërkuar dhe kjo procedurë ka filluar e para; ose



b) që kanë përfunduar me një vendim të një gjykate të palës së kërkuar; ose

c) që kanë përfunduar me një vendim të një gjykate të një shteti të tretë, i cili ka të drejtën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit në bazë të legjislacionit të palës së kërkuar.

Neni 19

Dokumentet e kërkuara

1. Organi gjyqësor ose subjekti i interesuar që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë:

i. një kopje të plotë të tekstit të vendimit të vërtetuar;

ii. nëse vendimi është marrë në mungesë: origjinalin apo kopje të vërtetuara të dokumenteve të nevojshme që provojnë se pala është njoftuar në mënyrë të rregullt;

iii. të gjitha dokumentet e nevojshme që vërtetojnë se vendimi nuk është më objekt i mjeteve të zakonshme të ankimimit dhe është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës.

2. Dokumentet e paraqitura në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit nuk i nënshtrohen kërkesave për legalizim apo formaliteteve të tjera.

Neni 20

Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore bëhet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palës së kërkuar.

2. Gjykata nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi gjyqësor, njohja dhe ekzekutimi i të cilit kërkohet, nuk përmban dispozita që parashihen sipas nenit 18 të kësaj marrëveshjeje.

3. Vendimi gjyqësor do të njihet dhe ekzekutohet pjesërisht nëse kërkohet njohja dhe ekzekutimi i pjesës, ose nëse vetëm një pjesë e atij vendimi plotëson kushtet për njohje dhe ekzekutim, sipas nenit 17 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 21

Procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit të njëres nga palët do të bëhet në palën

tjetër, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm.

KAPITULLI IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, zgjidhet nëpërmjet rrugëve diplomatike ose nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve qendrore të palëve, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të tyre.

Neni 23

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat ligjore të palëve dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të fundit, përmes kanaleve diplomatike të palëve, se procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përfunduar.

2. Marrëveshja lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe përfundon 6 muaj pasi njëra nga palët njofton palën tjetër për përfundimin e saj.

3. Secila prej palëve mund të kërkojë denoncimin e marrëveshjes, në çdo kohë, duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Denoncimi i kësaj marrëveshjeje hyn në fuqi 6 muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

Në dëshmi të kësaj të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në gjuhën shqipe.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ulsi Manja

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS

Albulena Haxhiu



DEKRET
Nr. 13534, datë 7.4.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 27/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 1, datë 22.2.2022

**PËR MIRATIMIN E NORMËS
USHQIMORE DITORE PËR TË
BURGOSURIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neni 36, pika 8, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të

paraburgosurve”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

UDHËZOJNË:

1. Përcaktimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Urdhri i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Shëndetësisë, i vitit 2006, “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi të përbashkët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**
Ogerta Manastirliu

Shtojcë

NORMA USHQIMORE PËR TË BURGOSURIT JO TË PUNËSUAR							
Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Norma ditore	Vlera energjitike/kcal	Proteina	Yndyrna	Glucide
1.	BUKË	gram	450	1102.5	45.45	10.35	220.95
2.	ORIZ	gram	40	145	2.8	0.24	35.04
3.	FASULE*	gram	50	185.5	11.8	1.25	25.85
4.	THJERRËZA	gram	0	0	0.0	0.0	0.0
5.	MAKARONA	gram	40	143	4.32	0.12	33.12
6.	MISH	gram	80	115.2	16.24	5.6	0
7.	DATH	gram	30	75	4.68	6.06	0.45
8.	GJALP	gram	20	152	0.16	16.68	0.22
9.	QUMESHT/KOS	gram	200	112	7	3.6	10
10.	VAJ	gram	30	270	0	30	0
11.	PERIME	gram	350	71	6.3	1.4	7.7
12.	FRUTA	gram	150	63	0.3	0.45	16.5
13.	SHEQER	gram	20	78	0	0	20.9
14.	KRIPË	gram	5	0	0	0	0
15.	ÇAJ	gram	2	0	0	0	0
16.	RECEL	gram	30	63	0.18	0	16.56
17.	VEZË	kokërr	1	93	0.13	0.111	0.01
18.	SALCË DOMATE	gram	4	2	0.036	0.016	0.456
19.	ERËZA	gram	0.4	0.264	0.0088	0.008	0.0388
	KUOTA DITORE			2640.5	99.4048	75.885	387.7948
					397.6	683.0	1881.2

*50 gr fasule në dmër dhe 50 gr thjerrëza në verë.

NORMA USHQIMORE PËR TË BURGOSURIT E PUNËSUAR							
Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Norma ditore	Vlera energjitike/kcal	Proteina	Yndyrna	Glucide
1.	BUKË	gram	500	1225	50.5	11.5	245.5
2.	ORIZ	gram	40	145	2.8	0.24	35.04
3.	FASULE*	gram	60	186.6	14.16	1.5	31.02
4.	THJERRËZA	gram	0	0	0.0	0.0	0.0
5.	MAKARONA	gram	40	143	4.32	0.12	33.12
6.	MISH	gram	100	204	20.3	7	0
7.	DATH	gram	40	100	6.24	8.08	0.6
8.	GJALP	gram	20	152	0.16	16.68	0.22
9.	QUMESHT/KOS	gram	200	112	7	3.6	10
10.	VAJ	gram	30	270	0	30	0
11.	PERIME	gram	350	71	6.3	1.4	7.7
12.	FRUTA	gram	150	63	0.3	0.45	16.5
13.	SHEQER	gram	30	118	0	0	31.35
14.	KRIPË	gram	5	0	0	0	0
15.	ÇAJ	gram	2	0	0	0	0
16.	RECEL	gram	40	84	0.24	0	22.08



17.	VEZË	kokërr	1	93	0.13	0.111	0.01
18.	SALCË DOMATE	gram	4	2	0.036	0.016	0.456
19.	ERËZA	gram	0.4	0.264	0.0088	0.008	0.0388
	KUOTA DITORE			2968.6	112.4948	80.705	433.6348
					450.0	726.3	1734.5

*60 gr fasule në dimër dhe 60 gr thjerrëza në verë.

NORMA USHQIMORE PËR TË BURGOSURIT E MITUR JO TË PUNËSUAR							
Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Norma ditore	Vlera energjitike/kcal	Proteina	Yndyrna	Glucide
1.	BUKË	gram	550	1347.5	55.55	12.65	270.05
2.	ORIZ	gram	40	145	2.8	0.24	35.04
3.	FASULE*	gram	50	155.5	11.8	1.25	25.85
4.	THJERRËZA	gram	0	0	0.0	0.0	0.0
5.	MAKARONA	gram	40	143	4.32	0.12	33.12
6.	MISH	gram	80	115.2	16.24	5.6	0
7.	DIATH	gram	30	75	4.68	6.06	0.45
8.	GJALP	gram	20	152	0.16	16.68	0.22
9.	QUMËSHI/KOS	gram	200	112	7	3.6	10
10.	VAJ	gram	30	270	0	30	0
11.	PERIME	gram	350	71	6.3	1.4	7.7
12.	FRUTA	gram	150	63	0.3	0.45	16.5
13.	SHEQER	gram	20	78	0	0	20.9
14.	KRIPË	gram	5	0	0	0	0
15.	ÇAJ	gram	2	0	0	0	0
16.	REÇEL	gram	30	63	0.18	0	16.56
17.	VEZË	kokërr	1	93	0.13	0.111	0.01
18.	SALCË DOMATE	gram	4	2	0.036	0.016	0.456
19.	ERËZA	gram	0.4	0.264	0.0088	0.008	0.0388
	KUOTA DITORE			2885.5	109.5048	78.185	436.8948
				2900	438.0	703.7	1747.6

*50 gr fasule në dimër dhe 50 gr thjerrëza në verë.

NORMA USHQIMORE PËR TË BURGOSURIT E MITUR TË PUNËSUAR							
Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Norma ditore	Vlera energjitike/kcal	Proteina	Yndyrna	Glucide
1.	BUKË	gram	600	1470	60.6	13.8	294.6
2.	ORIZ	gram	40	145	2.8	0.24	35.04
3.	FASULE*	gram	50	155.5	11.8	1.25	25.85
4.	THJERRËZA	gram	0	0	0.0	0.0	0.0
5.	MAKARONA	gram	40	143	4.32	0.12	33.12
6.	MISH	gram	100	204	20.3	7	0
7.	DIATH	gram	40	100	6.24	8.08	0.6
8.	GJALP	gram	20	152	0.16	16.68	0.22
9.	QUMËSHI/KOS	gram	200	112	7	3.6	10
10.	VAJ	gram	30	270	0	30	0
11.	PERIME	gram	350	71	6.3	1.4	7.7
12.	FRUTA	gram	150	63	0.3	0.45	16.5
13.	SHEQER	gram	30	118	0	0	31.35
14.	KRIPË	gram	5	0	0	0	0
15.	ÇAJ	gram	2	0	0	0	0
16.	REÇEL	gram	40	84	0.24	0	22.08
17.	VEZË	kokërr	1	93	0.13	0.111	0.01
18.	SALCË DOMATE	gram	4	2	0.036	0.016	0.456
19.	ERËZA	gram	0.4	0.264	0.0088	0.008	0.0388
	KUOTA DITORE			3182.5	120.2348	82.755	477.5648
					480.9	744.8	1910.3

*50 gr fasule në dimër dhe 50 gr thjerrëza në verë.

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**

Nr. 12, datë 8.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 1917, DATË 1.9.2014,
“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION
TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 1917, datë 1.9.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- në pikën 1 të udhëzimit, togfjalëshi “është 10 euro” zëvendësohet me togfjalëshin “është 1 euro”.

- në pikën 3, shkronja c, togfjalëshi “tarifën 10 euro/pasagjer” zëvendësohet me togfjalëshin “tarifën 1 euro/pasagjer”;

- kudo në udhëzim, togfjalëshi “Shoqëria “Tirana International Airport”(TIA)” dhe fjala “TIA” zëvendësohen me togfjalëshin “Shoqëritë e Aeroporteve Shqiptare”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

URDHËR

Nr. 124, datë 4.4.2022

**PËR MIRATIMIN E “PROGRAMIT TË
DETYRUESHËM TË TRAJNIMIT
VAZHDUES PËR NDIHMËS-
PËRMBARUESIT DHE PËRMBARUESIT
GJYQËSORË PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues për ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbaruesve, ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

**MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja**

**PROGRAMI I DETYRUESHËM
I TRAJNIMIT VAZHDUES PËR
NDIHMËSPËRMBARUESIT DHE
PËRMBARUESIT GJYQËSORË PRIVATË****KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Ky program përcakton metodat e trajnimit, programin e saktë të trajnimit dhe modulet e trajnimit, rregullat dhe kushtet për lëshimin e



certifikatave të pjesëmarrjes dhe rregulla të tjera të hollësishme për trajnimin vazhdues të detyrueshëm për ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë program termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Trajnimi vazhdues” nënkupton programin e detyrueshëm të trajnimit vazhdues për ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë, i cili bazohet në trajnimet profesionale vazhduese të organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbaruesve (Qendra), brenda të cilëve pjesëmarrësit plotësojnë numrin e caktuar të ditëve të trajnimit, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e parashikuara në ligj dhe akte nënligjore;

b) “Certifikatë” është vërtetimi i lëshuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës për përfundimin me sukses të trajnimit të detyrueshëm vazhdues;

c) “Kredit” është koha e zhvillimit të trajnimit vazhdues që llogaritet në 60 minuta për 1 kredit;

ç) “Ditë trajnimi” është dita e trajnimit vazhdues profesional që realizohet në jo më pak se 5 orë dhe që vlerësohet me 5 kredite.

Neni 3 Objektivat e programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues

Objektivat e këtij programi konsistojnë si më poshtë:

a) ofrimin e një programi trajnimi të përshtatshëm për përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe ndihmëspërmbaruesit që mundëson marrjen e njohurive për legjislacionin procedural civil, ligjin për përmbarimin gjyqësor privat, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e përmbaruesit gjyqësor privat dhe zhvillimin e procedurave përmbarimore, si dhe përditësimin e njohurive të tyre me zhvillimet që pëson legjislacioni në fuqi;

b) zhvillimin e një programi trajnues që mundëson përvetësimin e kompetencave dhe zbatimin e detyrave në ushtrimin e profesionit të përmbaruesit;

c) përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe aftësive praktike, ngritjen profesionale të përmbaruesve në përmbushjen e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi dhe krijimin e praktikave të unifikuara përmbarimore;

ç) nxitjen e aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit me palët gjatë procedurës përmbarimore dhe në komunikimin me personat e tretë;

d) nxitjen e frymës së bashkëpunimit profesional ndërmjet pjesëmarrësve në programin e formimit vazhdues, përmes trajnimeve përkatëse.

Neni 4 Synimi për kualifikim

Zhvillimi profesional i pjesëmarrësve në formimin vazhdues arrihet duke përvetësuar kompetencat e mëposhtme:

a) njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si përmbarues gjyqësor privat dhe përmirësimin e shërbimit përmbarimor;

b) aftësinë për t’u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme;

c) aftësinë për të zbatuar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë (profesionale dhe personale);

ç) aftësinë për kërkime të pavarura në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional;

d) kërkesat për menaxhimin dhe përmbushjen me sukses të procesit të punës (vetëorganizimi dhe disiplina, aftësia për t’u përballur me ngarkesë të lartë pune).

KREU II PROGRAMI I TRAJNIMIT VAZHDUES DHE ORGANIZIMI

Neni 5 Organizimi i programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues

1. Qendra organizon programin e trajnimit vazhdues profesional mbi bazën e një planifikimi vjetor.

2. Qendra merr masat e nevojshme administrative dhe akademike, dhe kujdeset në mënyrë të posaçme për trajnimin vazhdues të



përfituesve duke ofruar programe të formimit vazhdues dhe veprimtari të tjera trajnuese.

3. Qendra bashkëpunon me Dhomen Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë (Dhoma) për organizimin dhe funksionimin e programit vjetor të trajnimeve vazhduese për pjesëmarrësit.

4. Përmbauesit privatë dhe zëvendës-përmbauesit privatë detyrohen që, jo më pak se dy herë në vit, të jenë pjesëmarrës në trajnimet e detyrueshme vazhduese që organizohen nga Qendra.

5. Programi tematik dhe kalendari i të gjithë aktiviteteve që do të zhvillohen në kuadër të trajnimeve vazhduese, së bashku me metodologjinë e trajnimit, modelin e formularit të regjistrimit, publikohet elektronikisht në faqen zyrtare të Qendrës dhe të Dhomës.

Neni 6

Metodat dhe programi i trajnimit

1. Përmbajtja e programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues reflekton zhvillimin e kompetencave profesionale të pjesëmarrësve, i cili fokusohet në përmirësimin e aftësive praktike dhe vlerave etike të tyre, kryesisht në:

a) ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar;

b) hartimin e akteve dhe kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse në funksion të ushtrimit të kompetencave, konform legjislacionit në fuqi;

c) aplikimin e rregullave etike;

ç) përshtatjen me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të kompetencave;

d) zhvillimin e aftësive në fushën e përmbaimit gjyqësor;

dh) zhvillimin e praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e përmbauesve privatë;

e) zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese.

2. Kompetencat e mësipërme do të zhvillohen nëpërmjet moduleve të trajnimit vazhdues, të cilat janë bashkëngjitur si aneksi 1 i këtij programi, trajnimit praktik, si dhe punës praktike që mund t'i caktohet nga trajnerët.

3. Programi i detyrueshëm i trajnimit vazhdues përfshin:

a) trajnime të formimit vazhdues të të gjithë përmbauesve të licencuar në Republikën e Shqipërisë, anëtarë të Dhomës;

b) trajnime të formimit vazhdues të përmbauesve të rinj që janë anëtarë të Dhomës;

c) trajnime të formimit vazhdues për ndihmës-përmbauesit.

Neni 7

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të trajnimeve

1. Trajnimet përcaktohen në fillim të çdo viti kalendarik dhe publikohen në faqen zyrtare të Qendrës dhe të Dhomës. Çdo ndryshim në kalendarin e trajnimeve njoftohet jo më vonë se një muaj nga koha e zhvillimit të trajnimit.

2. Trajnimet e formimit vazhdues organizohen si trajnim njëditor (në jo më pak se 5 orë/5 kredite) apo si trajnim dyditor i quajtur “cikël trajnimi” (10 orë/10 kredite). Pjesëmarrësi në ciklin e trajnimit i nënshtrohet rregullave specifike të hartuara për një trajnim të tillë.

3. Trajnimet vazhduese mund të organizohen në formën e leksioneve/*workshop*-eve apo mënyrave të tjera interaktive dhe tematikat lidhen kryesisht me legjislacionin e shërbimit përmbaimit, fushën e të drejtës civile dhe procedurale civile, lidhur me ekzekutimin përmbaimit, aspekte të veçanta të fushës së të drejtës publike, rregullat mbi etikën profesionale të përmbauesve, e të tjerë.

4. Temat e trajnimeve përcaktohen në bashkëpunim me pedagogët/trajnerët e Qendrës.

5. Për raste të veçanta, nisur nga nevojat e ndihmës-përmbauesve/përmbauesve për trajnim, të ndryshimeve të legjislacionit dhe problemeve të praktikës, karakteri i programit të trajnimit vazhdues mund të lejojë përfshirjen e aktiviteteve trajnuese apo tematikave të tjera.

6. Çdo program trajnimi përmban qëllimin e trajnimit, temën e trajnimit, numrin e moduleve me temat përkatëse, kohëzgjatjen për çdo modul, kreditet përkatëse, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për pjesëmarrësit në trajnim.

7. Tematikat e trajnimit vazhdues të detyrueshëm përcaktohen çdo vit nga drejtori ekzekutiv i Qendrës, në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të Dhomës. Miratimi përfundimtar i tyre



bëhet nga ministri i Drejtësisë, me propozim të Dhomës.

Neni 8

Vendi i zhvillimit të trajnimeve vazhduese

Trajnimet vazhduese organizohen në ambientet e Qendrës ose në ambiente të tjera, të cilat mund të kontrahohen nga Qendra, me qëllim zhvillimin e trajnimeve dhe garantimin e aksesit të personave të konfirmuar për pjesëmarrje.

KREU III

ORGANIZIMI I TRAJNIMIT

Neni 9

Regjistrimi në kurset e trajnimit vazhdues

1. Qendra njofton ndihmëspërmbaruesit/përmbaruesit në rrugë elektronike lidhur me programin tematik dhe kalendarin e aktiviteteve trajnuese, të cilat do të ndiqen prej tyre.

2. Çdo aktivitet trajnues publikohet në faqen elektronike të Qendrës dhe të Dhomës, dhe përmban të dhëna lidhur me grupin e pjesëmarrësve në të, përmbajtjen narrative ose përshkrimin e kursit të trajnimit, vendin e organizimit, kohëzgjatjen, datat e parashikuara për zhvillimin e tij, agjendën dhe mbështetjen financiare.

3. Regjistrimi në aktivitetet trajnuese është individual dhe kryhet sipas modelit të formularit të regjistrimit që publikohet në faqen zyrtare të Qendrës dhe të Dhomës.

4. Regjistrimi konsiderohet i vlefshëm nëse është paraqitur apo është kryer jo më vonë se tri ditë nga data e zhvillimit të trajnimit përkatës.

5. Qendra përcakton listën e pjesëmarrësve në çdo sesion trajnues, duke marrë parasysh kërkesat individuale, si dhe referuar përcaktimeve në këtë program.

6. Listat e pjesëmarrësve miratohen nga drejtori ekzekutiv i Qendrës.

7. Sekretaria përgjegjëse për formimin vazhdues e Qendrës harton listën e plotë të pjesëmarrësve për të gjithë Republikën, të ndarë sipas kurseve të programit të formimit vazhdues.

8. Përjashtimisht, Qendra, për raste të veçanta dhe përjashtimore, për të mos penguar procesin e trajnimit, nisur nga nevojat për trajnim, mund të

përditësojë listat e pjesëmarrësve dhe aktiviteteve trajnuese në formimin vazhdues.

9. Pas miratimit të listave, Qendra procedon me njoftimin individual të personave që duhet të marrin pjesë nëpërmjet ftesave elektronike për veprimtarinë/të përkatëse trajnuese.

10. Ftesat për pjesëmarrje në aktivitetet trajnuese dërgohen në mënyrë elektronike minimalisht një muaj përpara datës së caktuar për zhvillimin e aktivitetit. Dhoma kujdeset që të mos krijohen pengesa në frekuentimin e trajnimeve përkatëse.

Neni 10

Pjesëmarrja në aktivitetet trajnuese të programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues

1. Qendra mban të gjithë të dhënat e pjesëmarrjes në sesionet trajnuese të tilla, si: listën e të ftuarve në çdo aktivitet, listën e pjesëmarrësve, duke i pasqyruar të detajuara sipas sesioneve përkatëse dhe listën e të pajisurve me certifikatë. Listat përbëhen nga sesioni i paradites dhe i pasdites. Çdo pjesëmarrës është i detyruar që të firmosë prezencën e tij për të vërtetuar ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të aktivitetit në të gjitha sesionet e tij, në rast të kundërt nuk certifikohet. Kjo listë pasqyrohet edhe në një regjistër të veçantë, nëpërmjet një numri rendor, bazuar në certifikatat e marra.

2. Qendra mban të dhëna lidhur me fushat e trajnimit, temën e sesionit trajnues, periudhën e aktivitetit, vendin e zhvillimit, ekspertët, lehtësuesit apo moderatorët, si dhe mbështetjen financiare, nëse ka.

3. Në rastet e mospjesëmarrjes në trajnimet vazhduese të detyrueshme, veprohet në përputhje me parashikimet e ligjit për shërbimin përmbarimor gjyqësor.

4. Në përfundim të çdo aktiviteti trajnues, pjesëmarrësve u përcillet një kopje elektronike e temës respektive dhe një listë sintetike bibliografie (të asaj ku stafi akademik është mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme).



KREU IV

RREGULLAT DHE KUSHTET PËR
LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË
PJESËMARRJES

Neni 11

Lëshimi i certifikatës së pjesëmarrjes

1. Në fund të programit të detyrueshëm për trajnimin vazhdues, pjesëmarrësit pajisen me certifikatën e përfundimit me sukses të trajnimit vazhdues, që lëshohet nga Këshilli Drejtues.

2. Nuk pajisen me certifikatë pjesëmarrësit që mungojnë qoftë edhe një seancë të trajnimit vazhdues. Në këtë rast, me kërkesë të tyre, pjesëmarrësit mund të marrin vërtetim vetëm për kohën që kanë frekuentuar.

Neni 12

Elementet e certifikatës së pjesëmarrjes

1. Certifikata përmban këto elemente:
 - a) emri;
 - b) mbiemri;
 - c) datat e zhvillimit të trajnimit vazhdues;
 - ç) titulli i programit/trajnimit;
 - d) numri i krediteve;
 - dh) numri i regjistrimit;
 - e) nënshkrimin dhe vulën e organit përgjegjës për lëshimin e tyre.
2. Në certifikatë krahas logos së Dhomës vendoset dhe logoja e Qendrës.
3. Certifikata që Dhoma/Qendra lëshon në bashkëpunim me institucionet me të cilat ka lidhur marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit përmban edhe logon e institucionit partner, si dhe të dhënat e autoritetit që certifikon këtë trajnim të përbashkët.

ANEKS 1

MODULET E TRAJNIMIT VAZHDUES

Moduli i programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues për përmbartuesit gjyqësorë privatë	
Trajnime që përmbajnë njohuri të specializuara dhe të thelluara rreth tematikave të mëposhtme, por pa u kufizuar në to:	
1	Legjislacioni mbi ekzekutimin e detyruar. Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare.
2	Titujt ekzekutivë. Urdhri i ekzekutimit. Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre.
3	Detyrimi. Origjina e detyrimit. Aktet për dhënien e kredive bankare. Kontratat bankare. Detyrimet monetare.
4	Procedurat e falimentimit. Përmbartimi ndaj debitorit dhe pronave të tij.
5	Vendimet gjyqësore me ekzekutim të përkohshëm. Masat e sigurimit të padisë. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave administrative.
6	Paraqitja dhe hartimi i padisë, deklaratat e mbrojtjes. Kundërpadia. Heqja dorë nga gjykimi dhe e drejta e padisë.
7	Njoftimet. Mënyra e njoftimit. Roli i përmbartuesit gjyqësor në procesin e njoftimeve. Rëndësia e akteve të nxjerra nga përmbartuesi gjyqësor, mënyra e komunikimit të tyre dhe rëndësia



	e njoftimit të palëve në proces.
8	Parashkrimi, afatet. Ndërprerja dhe pezullimi i parashkrimit. Prekluziviteti.
9	Ekzekutimi dhe shuarja e detyrimeve. Vendi, afati i ekzekutimit të detyrimit.
10	Zëvendësimi dhe kalimi i kredisë.
11	Pengu. Hipoteka. Dorëzania.
12	Preferimet (privilegjet). Radha e preferimit në procesin përmbartimor.
13	Etika dhe komunikimi. Rëndësia e Kodit të Etikës. Etika në ofrimin e shërbimit publik dhe etika deontologjike.
14	Ekzekutimi mbi sende të luajtshme dhe sende të paluajtshme. Ankandi.
15	Aktiviteti dytësor i përmbartuesit gjyqësor privat.
16	Papajtueshmëritë me funksionin e përmbartuesit gjyqësor privat. Konflikti i interesit. Konfidencialiteti dhe praktika të ndaluara të përmbartuesit gjyqësor privat.

Moduli i programit të detyrueshëm të trajnimit vazhdues për ndihmëspërmbartuesit

Trajnime që përmbajnë njohuri të specializuara dhe të thelluara rreth tematikave të mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

1	Roli i shërbimit përmbartimor në sistemin e drejtësisë. Përmbartimi midis ligjit dhe ekonomisë. Terminologjia e ekzekutimit.
2	Përmbartuesi gjyqësor. Struktura, funksionet. Marrëdhënia me palët, institucionet publike, subjektet private dhe bankat në proceset e ekzekutimit të detyrueshëm. Tarifat dhe kostot e shërbimit përmbartimor.
3	Titujt ekzekutivë. Urdhri i ekzekutimit. Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre.
4	Vënia në ekzekutim e një titulli ekzekutiv. Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm. Hapat proceduralë të ekzekutimit. Legjislacioni bazë mbi ekzekutimin e detyruar.
5	Njoftimet dhe afatet. Mënyra e njoftimit. Rëndësia e njoftimit të palëve në procesin përmbartimor.
6	Aktiviteti dytësor i përmbartuesit gjyqësor privat.
7	Zyra e përmbartimit privat, funksionet, organizimi dhe veprimtaria e përmbartuesit gjyqësor privat.
8	Etika dhe komunikimi. Kuptimi i vlerave dhe etikës në biznes. Rëndësia e Kodit të Etikës.



URDHËR
Nr. 133, datë 7.4.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 372, DATË 11.6.2021, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR COVID-19 NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; nenit 9, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; nenit 5, pika 6, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”; pikës 5 të urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në institucionet e

ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, përcjellë me shkresën nr. 3649 prot., datë 29.3.2022,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohen drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Sektori i Shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë